



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 140, datë 28.03.2023

PËR

**FILLIMIN E FUNKSIONIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SARANDË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 135, pika 1, 147, pika 1, 147/a, shkronja “ë” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13 të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenin 61, paragrafi 2, shkronja “ë” të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I :

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë vazhdon funksionimin nga data 1.5.2023 me emërtimin Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me seli në adresën: Lagja nr.1, Rruga “Onhezmi”, Godina 69, Sarandë.
2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë përcaktohet me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Rregullat standarde për strukturën dhe organika e administratës gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR